



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSHMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI	
Nr. / Br. / No. <u>353</u>	Nr. ifaq/ Br. str / No. pg <u>52</u>
Data / Datum / Date: <u>18/02/2020</u> Pejë / Pod	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

SENATI

Ref.

Datë:

## STRATEGJIA PËR KËRKIME SHKENCORE 2019 – 2024

Pejë, 2019

## Përbajtja

1. Hyrje .....	3
1.1 Parathënie .....	3
1.2 UHZ në retrospektivë .....	3
2. Vizioni dhe misioni .....	4
2.1 Vizioni .....	4
2.2 Misioni .....	4
3. Qëllimi dhe objektivat .....	4
3.1 Objektiva 1. Ngritja dhe zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore.....	5
3.2.Objektiva 2. Hapje dhe zhvillimi i programeve të hulumtimit .....	5
3.3. Objektiva 3. Ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore dhe artistike .....	6
3.4.Objektiva 4. Krijimi i një ambienti të qëndrueshëm infrastrukturor në fushën e kërkimeve.....	6
3.5.Objektiva 5. Mbështetja financiare e hulumtimeve shkencore.....	7
4.Monitorimi dhe analizat vlerësuese.....	7
4.1.Matja e performancës.....	8
4.2.Rezultatet e pritura .....	8
Referencat .....	9
PLANI I ZBATIMIT DHE BUXHETI.....	10

## **1. Hyrje**

### **1.1 Parathënie**

Strategjia Kërkimore 2019-2024, në Universitetin Haxhi Zeka(UHZ)-Pejë, ka për qëllim të pasqyrojë vizonin dhe objektivat e rëndësishme që duhet të plotësohen si përgjigje ndaj sfidave bashkëkohore të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme, si dhe realizimin e kërkësave gjithnjë e më të mëdha të akterëve të ndryshëm për njohuri të reja të bazuara në kërkime shkencore. Përmes kësaj strategjie ne do te bëjmë përspejtimin e përpjekjeve për të vendosur hulumtimet shkencore në thelbin e gjithë veprimitarës akademike të UHZ. Gjithashtu në bazë të kësaj strategjie, ne synojmë të rrisim aktivitetin tonë si një institucion që jo vetëm krijon dhe avancon njohuritë e reja, por edhe atë që jep kontribut të rëndësishëm në sfidat kryesore sociale, ekonomike dhe mjedisore në vend, rajon dhe më gjerë. Kjo nuk mund të bëhet pa një strategji të qartë, me njerëzit e duhur, burimet e duhura dhe të kuptuarit e mjedisit në të cilin veprojmë. Meqenëse kërkimet brenda UHZ duhet të kontribuojnë në zgjidhjen e sfidave të ndryshme atëherë vlerat, parimet themelore të lirisë akademike dhe priorititetet e rëndësisë strategjike duhet të ndërlidhen me Planin Strategjik të UHZ 2017-2022.

### **1.2 UHZ në retrospektivë**

Themelimi i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë si institucion arsimor kërkimor e shkencor, i cili jep diploma e grada shkencore deri në nivelin e doktoratës është mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës sipas nenit 145 (pika 2), duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të ligjit nr. 03/L – 189, të administratës shtetërore të Republikës së Kosovës.

UHZ në Pejë i themeluar në vitin 2011, është pasardhës i Shkollës së Lartë Ekonomike në Pejë, e themeluar në vitin 1960, dhe më pas e transformuar në Shkollën e Biznesit në vitin 2001, si dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Biznes (FSHAB) në vitin 2004.

UHZ në Pejë, për nga madhësia e universiteteve publike është i dyti në Kosovë duke përfshirë 5 fakultete, si: Fakultetin e Biznesit; Fakultetin Juridik; Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit; Hotelerisë dhe Mjedisit; Fakultetin e Agrobiznesit dhe Fakultetin e Arteve

Aktualisht në kuadër të Universitetit UHZ në Pejë, janë të akredituara 15 programe në nivelin Bachelor dhe 5 programe në nivelin Master, ndërsa ligjëratat organizohen në gjithsej 4 objekte të cilat përdoren për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjatë periudhës 2011/12, numri i studenteve të regjistruar në UHZ në Pejë ishte 1161, me 9 profesorë në marrëdhënie pune të rregullt dhe 25 profesorë të angazhuar nga jashtë, duke u rritur pastaj në afro 14.000 në vitin 2018, me gjithsej 40 profesorë në marrëdhënie pune të rregullt dhe 30 profesorë të angazhuar nga jashtë UHZ.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i UHZ në Pejë, është mjaft aktiv dhe deri më tanë është i përfshirë në 6 projekte Tempus dhe Erasmus+, duke dërguar stafin akademik dhe studentet në mobilitete për 8 vjet radhas në Angli, në Slloveni, në Suedi, në Irlandën Veriore, në Itali, në Bullgari, në Gjermani, në Austri, dhe në vendet e tjera pjesëmarrëse në programe të ndryshme mobiliteti.

Gjithashtu UHZ në Pejë, ka marrëveshje bashkëpunimi me mbi 30 universitete dhe institucione tjera kërkimore vendore e ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim krijimin e programeve të përbashkëta të studimit, shkëmbimin e profesorëve dhe studentëve, botimin e teksteve, revistave dhe organizimin e konferencave-simpoziumeve të përbashkëta. Në vitet e kaluara, UHZ ka organizuar edhe një numër të

konsiderueshëm te Konferencave shkencore vendore e ndërkontaktuale ku studentët e tanë dhe nga rajoni kanë prezantuar punimet e tyre hulumtuese.

Duhet theksuar se UHZ ka bërë përgatitjet e duhura në themelimin e instituteve hulumtuese-shkencore dhe qendrave tjera kërkimore të emërtuara si "Nga teoria në praktikë", dhe është anëtare e rrjetit: European Network for Academic Integrity (ENAI). UHZ në Pejë ka dy biblioteka të cilat disponojnë me gjithsej 2678 tituj të librave të fushave të përcaktuara për studime në UHZ.

Në aspektin e hulumtimeve shkencore UHZ me stafin akademik shquhet për aktivitetin hulumtues-kërkimor duke botuar punime shkencore artistike në revista ndërkontaktuale, monografi të ndryshme në revista kombëtare dhe një numër të konsiderueshëm të teksteve mësimore universitare. Prezantimet e punimeve shkencore të përgatitura nga stafi akademik dhe studentët e UHZ-së gjithashtu janë paraqitur edhe ne konferencat vendore dhe ndërkontaktuale.

## 2. Vizioni dhe misioni

### 2.1 Vizioni

UHZ ka për synim që të jetë një institucion i dalluar në vend dhe rajon në hulumtimet shkencore dhe artistike që ndërlidhen edhe me kërkimesat e tregut dhe nevojave të bizneseve duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë vendore dhe ndërkontaktuale.

### 2.2 Misioni

Krijimi i njojurive te reja përmes kërkimeve shkencore të bazuara në standarde hulumtimeve ndërkontaktuale dhe zhvillimi i ideve inovative aplikative në funksion të plotësimit të nevojave të shoqërisë.

Aplikimi i standardeve më të larta për arsimin universitar dhe pasuniversitar si përgjigje ndaj nevojave të tregut dhe sfidave të reja të shoqërisë bashkëkohore.

Rekrutimi i studentëve dhe profesorëve më të mirë në fushat interdisiplinare në implementimin e strategjisë kërkimore në universitet.

Vendosja transparente e mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës për personelin akademik dhe hulumtuesit shkencor duke nënkuqytuar këtu diversitetin dhe aspektin gjinor në universitet.

## 3. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i strategjisë kërkimore në UHZ, është që të konsolidojë dhe forcojë pozicionin e tij në të gjitha nivelet, duke ngritur kërkimet shkencore 30%, nga niveli i tanishëm në 5 vitet e ardhshme, por edhe të promovojojë një mjesdit të hapur intelektual në të cilin zhvillimi i hulumtimit shkencor është i bazuar në inovacion, dije dhe etikë dhe ka për synim zgjidhjen e problemeve e çështjeve komplekse me të cilat përballet sot shoqëria bashkëkohore.

Këto synime strategjike janë të përcjella me një varg veprimesh; disa nga këto veprime janë programe dhe aktivitete që janë në fazën fillostarte, të tjerat janë vazhdimësi dhe zgjerime të nismave aktuale, duke përfshirë këtu edhe planet e reja. Të gjitha këto iniciativa kanë për qëllim të sigurojnë dhe avancojnë ndikimin tonë në hulumtimet shkencore.

UHZ për periudhën kohore 2019-2024, është përkushtuar në realizimin e këtyre 5 objektivave kryesore të strategjisë kërkimore:

- Ngritja dhe zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore
- Hapje dhe zhvillimi i programeve të hulumtimit
- Ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore dhe artistike
- Krijimi i një ambienti të qëndrueshëm infrastrukturor në fushën e kërkimeve
- Mbështetja financiare e hulumtimeve shkencore

### **3.1 Objektiva 1. Ngritja dhe zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore**

Lidhja midis kërkimit, arsimit dhe shoqërisë më të gjerë do të përforcohet dhe do të zhvillohet me iniciativa të ndryshme. Kërkimet në UHZ do të kenë një shtrirje të gjerë ndërdisiplinore dhe rezultatet e hulumtimit do të kontribuojnë në zhvillimin shoqëror, për të cilën shpesh kërkonet një qasje përtrej kufijve nacional. Të kuptuarit e elementeve dhe forcave komplekse brenda natyrës dhe shoqërisë kërkon ekzaminim nga perspektiva e disiplinave të shumta. Sfidat kryesore të shoqërisë rrallëherë mund të adresohen duke përdorur gjeljet vetëm me një discipline kërkimore. Multidisiplinariteti krijon sinergji dhe zhvillim të mundësinë e ideve krijuese.

Hulumtimi në UHZ është i rëndësishëm edhe për shoqërinë dhe gjithashtu do të bëhen përgatitjet për sfidat shoqërore në nivelin lokal, rajonal, kombëtar dhe global.

- 1.1.1. Funksionalizimi dhe avancimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike
- 1.1.2. Krijimi dhe profilizimi i revistave shkencore në kuadër të UHZ
- 1.1.3. Themelimi dhe funksionalizimi i instituteve në kuadër të UHZ
- 1.1.4. Krijimi i "scientific parks" ku do të përfshihen institutet, qendrat e konsulencës laboratorët e veçantë për hulumtime shkencore si dhe i një punëtorie përpunimin e ushqimeve
- 1.1.5. Përkrahja e stafit akademik për pjesëmarrje, botime dhe projekte të përbashkëta hulumtuese dhe artistike në nivel ndërkombëtar
- 1.1.6. Përfshirja e studentëve në projekte hulumtuese

### **3.2. Objektiva 2. Hapje dhe zhvillimi i programeve të hulumtimit**

Për të balancuar aftësitë ekzistuese me potencialin dhe mundësitë, ne do të përdorim në mënyrë optimale burimet e tanishme. Universiteti do të vazhdojë të zhvillojë gamën e tij të fushave të kërkimit, duke punuar në kërkimet multidisiplinare.

Këto do të janë në fushat me përparësi kërkimore të zgjedhura me kujdes, ku UHZ ka forca të veçanta, ose ku udhëheqja dëshiron të zhvillojë forca të veçanta si pjesë e pozicionimit strategjik të institucionit.

- 3.2.1 Hapja e programit të doktoratës
- 3.2.2 Ndërtimi i programeve studimore në bazë rezultateve hulumtuese
- 3.2.3 Etika e kërkimeve si një koncept të përfshihet në hulumtime
- 3.2.4 Avancimi i zyrës për zhvillim akademik dhe asaj të karrierës
- 3.2.5 Zhvillimi i kurseve të doktoratës

- 3.2.6 Zhvillimi i kurseve për publikime kualitative në revista ndërkombëtare të indeksuara në bazat e të dhënave më të njoitura si: Thomson Reuters, Scopus, EBSCO etj. dhe avancimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

### **3.3. Objektiva 3. Ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore dhe artistike**

Një dimension gjithnjë e më i rëndësishëm i strategjisë sonë do të jenë bashkëpunimet dhe partneritetet, me studiues të tjerë dhe me një komunitet më të gjerë të financuesve dhe sponsorëve të kërkimit. Kjo do të ndërtojë rrjete të forta kërkimore dhe infrastrukturë me aftësinë për të adresuar çështjet e mëdha dhe gjenerimin e njojurive dhe njojurive të reja.

Bashkëpunimet kërkimore të kësaj natyre paraqesin mundësi strategjike për të përmirësuar shkallën, cilësinë dhe ndikimin e hulumtimit tonë. Ka shumë përfitime nga partneritetet bashkëpunuese ku studiuesit janë të ekspozuar ndaj perspektivave të ndryshme. Gjithashtu ato sjellin aftësi shumë të nevojshme plotësuese nga burimet dhe infrastruktura të ndryshme, si dhe mund të ofrojnë qasje në ekspertizë specifike të industrisë. Më tutje ato ofrojnë mundësi për burime shtesë ose të larmishme të financimit.

Partneritetet strategjike me studiuesit ndërkombëtarë mund të sjellin njojje globale për universitetin dhe përfitime për programet mësimore dhe hulumtuese.

Strategjia kërkimore me anën e kësaj objektive synon të adresojë çështjet si në vijim:

- 3.3.1. Ngritja e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta
- 3.3.2. Themelimi dhe realizimi i programeve të përbashkëta me universitet e tjera
- 3.3.3. Përfshirja më e madhe e stafit dhe studentëve në mobilitet
- 3.3.4. Mbështetja e studentëve (internship, vazhdim studimesh etj.).
- 3.3.5. Organizmi i konferencave ndërkombëtare multidisiplinare
- 3.3.6. Organizimi i shkollës verore (summer school)
- 3.3.7. Bashkëpunimi me akter të jashtëm (institute, qendra të konsulencës, biznese) të pajisur me infrastrukturë, si laboratorë, pajisje për standardizime etj., për studime dhe realizimin e hulumtimeve me interes të përbashkët.

### **3.4. Objektiva 4. Krijimi i një ambienti të qëndrueshëm infrastrukturor në fushën e kërkimeve**

Njësitë akademike dhe institutet e hulumtimit mbështeten në informacione të sakta dhe të besueshme kërkimore për të realizuar planifikimin strategjik, për të menaxhuar procesin e hulumtimit dhe për të përmirësuar raportimin tek organet e jashtme, siç janë financuesit dhe organet qeveritare. Një qeverisje e mirë dhe një sistem menaxhimi është një faktor kritik suksesi në zhvillimin e kërkimit intensiv të një universiteti.

Qasje e mirë në infrastrukturën kërkimore, si objektet kërkimore, performancë e lartë instrumentizimi, bibliotekat, grupimet e kompjuterëve, bazat e të dhënave të gjera etj., nuk është vetëm një kusht për hulumtime efektive individuale por gjithashtu ajo edhe krijon kushtet për bashkëpunim të shtuar me aktorë të ndryshëm në shoqëri.

Strategjia kërkimore me anën e kësaj objektive synon të adresojë çështjet si në vijim:

- 3.4.1. Ngritja e etikës në kërkime shkencore (softueri antiplagjiat )
- 3.4.2. Sigurimi i softuerëve të nevojshëm për hulumtime shkencore (SPSS, STATA, LISREL, M-FIT, NVIVO)
- 3.4.3. Qasjen në bazat e të dhënave online, bibliotekat dhe nototekat
- 3.4.4. Krijimi i bazës së të dhënave për evidentimin e të gjitha publikimeve individuale dhe grupore – profesor/student në kuadër të UHZ-së
- 3.4.5. Krijimi i infrastrukturës fizike

### **3.5.Objektiva 5. Mbështetja financiare e hulumtimeve shkencore**

Kërkuesat për burime financiare po bëhen gjithnjë e më të mëdha, dhe mundësitet për realizimin e tyre janë gjithnjë e më të komplikuara. Prandaj është thelbësore që sistemet financiare dhe buxhetore të jenë optimale dhe transparente për të gjitha kërkuesat e tillë. Për të optimizuar suksesin tonë në hulumtim, modeli ynë i buxhetit duhet të sinkronizohet për të mundësuar aktivitetin kërkimor në nivelin më të lartë. Kjo përfshin një kontroll të rregullt të modelit për të siguruar që ne jemi duke minimizuar pengesat për hulumtime, ose duke eliminuar sjelljet që janë paragjykuar për veprimtarinë kërkimore. Në mënyrë që të rritet përpjekja për hulumtim në Universitet do të jetë thelbësore që të diversifikohet baza e financimit edhe më gjerë, duke kërkuar më shumë përfondet ndërkombëtare.

Strategja kërkimore me anën e kësaj objektive synon të adresojë çështjet si në vijim:

- 3.5.1. Përmirësimi i procedurave të financimit të hulumtimeve shkencore dhe artistike
- 3.5.2. Mbështetja financiare me grante për hulumtime shkencore për udhëtime jashtë vendit (staf akademik dhe studentë)
- 3.5.3. Mbështetja financiare e pjesëmarrësve në projekte kërkimore edhe artistike me partnerët ndërkombëtarë.
- 3.5.4. Mbështetja me fonde për botime të teksteve universitare dhe punimeve shkencore e artistike
- 3.5.5. Mbështetja financiare e stafit dhe studentëve me pajisje elektronike
- 3.5.6. Mbështetja financiare e studios muzikore me pajisjet përcjellëse dhe sallës digitale

### **4.Monitorimi dhe analizat vlerësuese**

Në Strategjinë e Kërkimit të UHZ është thelbësore përcjellja e progresit dhe monitorimi i seçilit program, projekt dhe aktivitet i planifikuar, prandaj korrigimet eventuale, si rishikim për të kthyer sistemin në drejtimin e duhur, duhen të jenë në qendër të hartimit të programit të bazuar në prova dhe në përgjegjësi për rastet kur sistemi nuk është duke funksionuar sipas parashikimeve.

Të kuptuarit e procesit të monitorimit dhe vlerësimit është thelbësor për të përmirësuar strategjinë tonë. Një plan i detajuar i monitorimit dhe i vlerësimit është i nevojshëm për të shërbyer si një strukturë funksionale e cila ka për qëllim për të monitoruar dhe rishikuar fushat, projektet, iniciativat dhe planet kryesore të identifikuara në Strategjinë e Kërkimit.

Një plan i tillë do të zhvillohet në konsultimi me palët kryesore të interesit dhe është i nevojshëm ndër të tjera për evidentimin e rezultateve të arritura, mundësimin e monitorimit të progresit ndaj synimeve të strategjisë dhe kërkeseve përfundimtare e aktiviteteve të rishikuara.

Plani i monitorimit dhe i vlerësimit, do të jetë fleksibël dhe i arsyeshëm, dhe vazhdimisht do të shërbejë për të ripërcaktuar, rishikuar dhe përmirësuar përparësitë dhe objektivat e Strategjisë së Kërkimit.

Ne kemi identifikuar një seri indikatorësh për të vlerësuar përparimin dhe arritjet e përgjithshme të performancës. Në vazhdim do të zhvillojmë një plan të qartë të zbatimit të vlerësimit dhe një kornizë të detajuar monitorimi për të matur progresin e strategjisë sonë. Në veçanti, ne do të përcaktojmë masat e performancës me qëllimet strategjike të përshkruara në këtë strategji.

#### **4.1. Matja e performancës**

- Rritja e numrit të stafit të angazhuar në kërkime shkencore në të gjitha fushat e synuara në shkallën 30% nga niveli i tanishëm.
- Rritja e publikimeve të hulumtimeve në shkallën 30% nga niveli i tanishëm në revistat ndërkombëtare.
- Krijimi dhe funksionalizimi i 3 instituteve hulumtuese.
- Fillimi i programit te doktoratës dhe regjistrimi i 9 studentëve.
- Rritja e numrit të të diplomuarve në nivelin Master në shkallën 30% nga niveli i tanishëm
- Rritja e përqindjes së stafit akademik me gradë doktorate në 50%.
- Rritja e numrit të studiuesve të vlerësuar në shkallën 30% nga niveli i tanishëm.
- Rritja e vëllimit dhe vlerës së hulumtimit në bashkëpunim me institucionet tjera ndërkombëtare në shkallën 30% nga niveli i tanishëm.
- Përmirësimi në renditjen e UHZ në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar-uebometriks në shkallën 30% nga niveli i tanishëm.

#### **4.2. Rezultatet e pritura**

Implementimi i Strategjisë së Kërkimit të UHZ do të rezultojë në këtë mënyrë:

- Do të njihem si një Universitet i dalluar jo vetëm në studime, por edhe në kërkime shkencore.
- Të gjitha burimet e disponueshme do të harmonizohen me strategjinë tonë të kërkimit.
- Hulumtimi dhe inovacioni ynë multidisiplinair dhe ndër-sektorial në institutet e hulumtimit do të njihet për rëndësinë dhe ndikimin e tyre.
- Bashkëpunimet tona me organizatat e jashtme do të gjenerojnë nisma të përbashkëta dhe forcimin e hulumtimit dhe zgjerimin e aftësive tona kërkimore.
- Buxheti dhe sistemet mbështetëse, dhe infrastruktura kërkimore do të ndihmojnë në nxitjen e hulumtimit dhe të përsosmërisë së kërkimit.
- Studentët që mbarojnë studimet në UHZ do të jenë të edukuar mirë, të përgatitur për karriera të larmishme dhe në bazë të kërkimes globale.
- Njohja e njojurive të arritura do të pranohet edhe në arenën ndërkombëtare.

## **Referencat**

1. Plani Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021, MASHT, 2016.
2. Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2017.
3. Plani Strategjik i Universitetit Haxhi Zeka-Pejë 2017-2022.
4. EC Strategjia 2015-2019, Prizren, 2015.
5. Plani i veprimit të Planit Strategjik për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021, MASHT, 2016.
6. Bazat e kërkimit në edukim, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2013.
7. Rregullore për përkufizimin dhe funksionalizimin e pikave kontaktuese kombëtare të Kosovës, Horizont 2020, MASHT, 2018.
8. Ligji për veprimtari kërkimore shkencore, Kuvendi i Kosovës, 04/L-135, 2013.
9. Ligji për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe të teknologjisë, Kuvendi i Kosovës, 06/L-049, 2018.
10. Strategjia për Veprimtari Kërkimore-Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013-2016, UP, 2012.
11. Gjendja e kërkimit shkencor në Kosovë, "Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN"-2018.
12. Strategic Research Plan, University of Tasmania, 2014-2018.
13. UFS Research Strategy 2015-2019, University of Free State, 2015.
14. Strategic Research Plan 2018-2022, Universiteti i Tiranës, 2018.
15. Strategic Research Plan 2018-2022, University of Regina, 2018.
16. Research Strategy 2017-2021, Lund University, 2017.
17. Research Strategy 2015 – 2021, University of Sterling, 2015.
18. Research Strategy 2018-2022, Bond University, 2018.
19. Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, MASHT, 2016.

PLANI I ZBATIMIT DHE BUXHETI					
Treguesit objektivisht të verifikueshëm përmjet e arritjes së objektivave					
Treguesi	Gjendja e tanishme 2019	Caku 2022	Caku 2024	Indikatorët	
Zyra përmjet Kërkime Shkencore (ZKSH)	N/A	Zyre e veçantë përmjet KSH	Zyre e veçantë përmjet KSH	Vendimi përmjet themelimin e Zyrtës përmjet KSH	
Numri i personelit në ZKSH	0	2	2	Konkurset Kontrata e punës	
Numri i Instituteve të Hulumtimit	0	3	3	Organogrami i ri	
Strategjia përmjet Kërkime Shkencore	N/A	Duke u zbatuar	Duke u zbatuar	Dokumenti i Strategjisë përmjet Shkencore	
Buxheti vjetor përmjet kërkimore	N/A	425,400.00	854,400.00	Buxheti vjetor i UHZ-së	
Numri i stafit të trajnuar përmjet projekteve hulumtuese nga trajnerët e ndërkombëtarë	0	17	17	Evidencat e trajnimeve	
Numri i stafit të trajnuar përmjet projekteve hulumtuese nga trajnerët e brendshëm	0	15	25	Evidencat e trajnimeve	
Numri i projekteve hulumtimit të hartuara nga stafi akademik brenda një vitit	N/A	5	20	Projektet e hartuara	
Numri i platformave ku kanë qasje stafi akademik pa	1	5	5	Lista e platformave	

pagesë				
Numri i hulumtimeve në bashkëpunim me universitet/kolegët ndërkombe të brenda një viti	0	30	50	Hulumtimet e realizuara
Numri i hulumtimeve në bashkëpunim me universitet/kolegët vendorë brenda një viti	N/A	30	50	Hulumtimet e realizuara
Numri i hulumtimeve në bashkëpunim me universitet/kolegët nga UHZ brenda një viti	N/A	60	100	Hulumtimet e realizuara
Numri i hulumtimeve aplikative brenda një viti	N/A	15	75	Kontratat me palët e interesuara
Numri i stafit akademik të trajnuar për të shkruar punime shkencore	0	40	128	Evidencat e trajnimeve
Numri i publikimeve të stafit akademik në revista shkencore ndërkombe të	N/A	30	150	Punimet e publikuara
Revista shkencore multidisiplinare e UHZ-së me karakter ndërkombe të	N/A	Botohet 1 herë në vit	Botohet 2 herë në vit	Revista e botuar
Numri i stafit akademik që merr pjesë në konferencë ndërkombe të jashtë vendit brenda viti	N/A	60	300	Evidencat e pjesëmarrijes
Numri i konferencave ndërkombe të që organizohen nga UHZ brenda një viti	1	5	5	Evidencia e mbajtjes se konferencës
Buxheti vjetor për veprimtari e krijimtari artistike e kulturore	N/A	156,600.00	261,000.00	Buxheti vjetor i UHZ-së
Festivali ndërkombe të i UHZ-së	N/A	1 herë në vit	1 herë në vit	Evidencat nga festivali
Numri i stafit dhe i studentëve që marrin pjesë në festivale ndërkombe të jashtë vendit brenda një viti	2+2	12	20	Evidencat e pjesëmarrijes në festivale
Numri i konceriteve ndërkombe të organzuara nga UHZ brenda një viti	3	9	15	Evidencia e mbajtjes se koncerteve ndërkombe të

Numri i koncerave vendore të organizuara nga UHZ brenda një viti	5	15	25	Evidenca e mbajtje se koncerave vendore
Java Artistike Studentore e organizuar nga UHZ	1 herë në vit	1 herë në vit	5 herë	Evidencat e aktiviteteve

Rezultati 1: Ekzistojnë burime të mjaftueshme profesionale dhe financiare për veprimtarit kërkimore

Aktiviteti	Përshtatimi i aktivitetit	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës për zbatim operacionizimi i aktivitetit	Instituci oni/ Organiza ta mbëshitet ësse	Burimi i finansimit	Përshtatimi i kostos	Buxheti sipas viteve në euro					
							2020	2021	2022	2023	2024	Total
Aktiviteti 1.1	Përshtatimi i aktivitetit											
Krijimi i Zyres për Kërkime Shkencore (ZKSH) në nivel universiteti	UHZ përmes riorganizimit departamentit ekzistues për mësimdhënies, çështje akademike dhe kërkime shkencore, do të themelojë Zyren për Kërkime Shkencore (ZKSH) në nivel të universitetit, e cila do të marrë ekskluzivisht me pronovimin e këkimit shkencor dhe përkrahjen e stafit akademik për t'u marrë me	Periudha e zbatimit do te filloj menjëherë 2020	Rektorati	N/A	Buxheti i UHZ-së	2 persona x 500 euro x12 x 5 vite	12000	12000	12000	12000	12000	60000

	veprintari kërkimore.					
	Në kuadër të kësaj zyre do të punëshen dy persona si stafi përhershëm.					

Aktiviteti	Përshtkimi i aktivitetit	Periudha e zbatimit		Instituci oni/ Organiza ta mështetëse	Përshtkimi i kostos	Buxheti sipas viteve në euro			
		dhe	Institucion i përgjegjës për zbatim			2020	2021	2022	2023
Aktiviteti 1.2	Përshtkimi i aktivitetit	Përgatitjet për themelimin e instituve		Njësité akademike	UHZ	Drejtori i institutit			
Themelimi dhe funksionalizimi i Instituteve të Hulumtimit në nivel	UHZ do të fillojë me përgatitjen dhe themelimin e Instituteve hulumtuese në njësítë akademike. Këto institute do të udhëhiqen nga stafi i biznesit	Gjate viteve 2020-2024 do të funksionalizohen 3 institute:	KD	MASHT	Buxheti i UHZ-së	1x500x12x5vjet	4800	19200	28800
			Senati	Qeveria	Zyrtar i Institutit				28800
			Donatorët		1x300x12x5 vjet				110400

Aktiviteti	Përshtkimi i	Periudha e	Institucioni	Instituci	Burimi i	Përshtkimi i	Buxheti sipas vitiave në euro
							2021
universiteti dhe në nivel të njësive akademike	ekzistues akademik dhe do të merrin me përgatijen dhe realizimin e veprimtarisë shkençore sipas karakteristikave të njësise akademike. Përprojeket do të koordinohen në bashkëpunim me Zyrën për Kërkime Shkençore, Institutet do t'i kontribuojnë zhvillimit duke gjenierar këshuu edhe të hyra vetaake.	dhe turizmit (2020)  2. Institut i Juridik (2021)  3. Institut i bujqësisë dhe mjetit (2022)	Drejtori i institutit  1x500x12x5vj et	Zyrtar i Institutit  1x300x12x5 vjet	Drejtori i institutit  1x300x12x5 vjet	Totali i buxhetit për aktivitet (euro):	4800 19200 28800 28800 28800 110400
							vbn

	aktivitet	zbatimit dhe operacionalizimi i aktivitetit	përgjegjës për zbatim	financiimit	kostos	Total				
						2020	2021	2022	2023	2024
Aktiviteti 1.3	Përshtatni i aktivitetit	Hartimi i Stratejisë për Kërkime Shkençore	UHZ do të hartojë dhe miratojë Stratejinë për Kërkime Shkençore për prinddhën pesënjecare, në të cilin do të parashihen në detaje aktivitetet që do të zhvillohen nga UHZ dhe staffi i tij akademik në fushën e veprimtarisë kërkimore, përfshirë përgatitjen e projekteve hulumtuese, realizimin e hulumtimeve shkençore e aplikative, publikimet në revista shkençore te besteshme, pjesëmarrjen në konferanca shkençore ndërkombëtare, etj.. Kjo strategji do të jetë në koherencë kë plotë me strategjinë gjithëpërfshirese zhvillimore të UHZ	Buxheti i UHZ-së	0	0	0	0	0	0
			Strategjia për kërkime shkençore e hantuar dhe e mirauar	Rektorati/Sena ti	N/A					
						Donatorët dhe/ose Institucione t Qendore				

Aktiviteti	Përshtkimi i aktivitetit	Periudha e zbatimit dhe operacionizimi i aktivitetit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Instituci oni/ Organiza ta mbështet ëse	Burimi i financimit	Përshtkimi i kostos	Buxheti sipas viteve në euro					
							2020	2021	2022	2023	2024	
Aktiviteti 1.4:	Përshtkimi i aktivitetit	Perfshira e staffit me mobilitete(15person a) Botimi i revistës me kuaðer te Fakultetit Organizimi i konferencës Studentore Seminare/Think tank/Masterclasse te ndryshëm (te 5 Fakulteteve)	Rektorati Erasmus MASHT Palet e interesit F/B, MTHM				30000 15x2000=30000 1x1000=1000 1x1000=1000 10000 0 0	30000 1000 1000 1000 4000 10000 3000 3000 5000 0	30000 1000 1000 1000 4000 10000 3000 3000 5000 0	30000 1000 1000 1000 4000 10000 3000 3000 5000 0	30000 1000 1000 1000 4000 10000 3000 3000 5000 0	30000 1000 1000 1000 4000 10000 3000 3000 5000 0
Ndaria e buxhetit të veçantë për kërkime shkencore	Bazaar në Strategjinë për Kërkime Shkencore, UHZ për çdo vit do të ndajë buxhet të veçantë për vepriminari në kërkimore, perfshire përgatitjen e projekteve hulumtuese, realizimin e hulumtimeve shkencore e aplikative, publikimet											
Total i buxhetit për aktivitet (euro):							0	0	0	0	0	

	në revista shkencore të besueshme, pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, etj..	Mbeshjetja e studenteve per internship, trajnime, etj. 30 studente)	F/B,MTHM,FJ ,FAG,FA				
	Një pjesë e mjeteve do të dedikohen kryekëput për përkrahjen e hulumtimeve studentore dhe integrimin e hulumtimeve shkencore në mësimdhënëse.	Organizimi i konferencave ndërkombetare me universitet tjetra Organizimi i shkollës vlore me studentet vendor dhe ndërkombetare	Donatorët dhe/ose Institucionet Qendrore	Erasmus	30000	30000	30000
		Përveç kësaj, UHZ do t'i furnizojë edhe laboratorët me rekuizitat dhe pajisjet e nevojshme për të realizuar kërkime shkencore (për më shumë rreth kësaj, shih aktivitetet përfshirët në Fushën 7 të këtij dokumenti).					
					74000	99000	74000
				Totali i buxhetit për aktivitet (euro):	74000	99000	74000
							420000

Aktiviteti	Përvkrimi i aktivitetit	Periudha e zbatimit dhe operacionizimi i aktivitetit	Institucion i përgjegjës për zbatim	Instituci oni/ Organiza ta mbështet ësse	Burimi i finançimit	Përvkrimi i kostos	Buxheti sipas viteve në euro				
							2020	2021	2022	2023	2024
Aktiviteti 1.5:	Përvkrimi i aktivitetit										
